

GJYKATA E APELIT

Çështja me numër: PAKR 943/13
Data: 25 Gusht 2014

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS, ne kolegjin e gjyqtarëve të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it James Hargreaves në cilësi të Gjyqtarit Kryesues dhe gjyqtarit raportues, si dhe Gjyqtarëve të EULEX-it Manuel Soares dhe Gjyqtarit të Apelit Driton Muharemi në cilësi të anëtarëve të Kolegjit, me pjesëmarrjen e Clemens Muller, zyrtarit Ligjor të EULEX-it.

në çështjen penale kundër

S.P., i biri i xxx dhe nënës xxx, i lindur më datë xxx Në xxx, xxx, me banim në xxx, xxx, xxx i diplomuar, xxx dhe xxx, me përkatësi etnike serbe.

I liruar me aktgjykim të shkallës së parë me nr. P200/2010 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 28 Shkurt 2013 për veprat penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose të Autorizimit në sipas Nenit 339 (3) në lidhje me Nenin 23 (bashkëkryerje) të Kodit të Përkohshëm të Kosovës – Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25, në fuqi që nga data 06.04.2004 deri më datë 31.12.2012 (tani e tutje KPK 2004) (Pika e parë e Akuzës), Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës sipas Nenit 340 (1) dhe (3) në lidhje me nenin 23 (bashkë-veprim) të KPK-së të 2004 (Pika e dytë e akuzës) Mashtrim në Detyrë sipas Nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me Nenin 23 (bashkëkryerje) të KPK-së 2004 (Pika 6);

B.G., i biri i xxx dhe nënës xxx, i lindur më datë xxx ne xxx, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, xxx, me banim në xxx, rruga xxx, ish xxx, xxx dhe xxx, me diplomë të universitetit, serb i Kosovës.

i shpallur fajtor në shkallën e parë dhe i dënuar me katër (4) vjet burgim dhe me dënim plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në shërbimet publike dhe në administratën publike për një periudhë dy (2) vjeçare, sipas Aktgjykimit me numër P 200/2010 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 28 Shkurt 2013 pasi që është shpallur fajtor për veprat penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose të Autorizimit sipas Nenit 442 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës – Ligji nr. 04/L-082, në fuqi që nga data 01.01.2013 (tani e tutje KPK) (Pika 2 e akuzës), Mashtrim në detyrë sipas Nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me Nenin 23 (bashkë kryerje) të KPK-së të 2004 (Pika 6 e Akuzës);

N.V., i biri i xxx dhe xxx, i lindur më datë xxx në xxx, xxx, me banim në xxx, xxx, xxx deri në muajin Mars 2013, me shkollë të mesme të kryer, xxx dhe xxx, serb i Kosovës;

i dënuar në shkallën e parë me tre (3) vjet e gjashtë (6) muaj burgim dhe me dënim plotësues të ndalesës nga ushtrimi iu funksioneve në shërbimet publik ose në administratën publike për një periudhë dy (2) vjeçare sipas Aktgjykimit me numër P200/2010 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 28 Shkurt 2013 pasi që është shpallur fajtor për veprat penale të Shpërdorimit

te Pozitës Zyrtare ose të Autorizimit sipas Nenit 442 (1) të KPK-së (Pika 3 e Akuzës) dhe Mashtrim në Detyrë sipas Nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me Nenin 23 (bashkë-veprim) të KPK-së të 2004 (Pika 6 e Akuzës)

M.S. i biri i xxx dhe nënën xxx, i lindur më datë xxx në xxx, xxx, më banim në xxx, në rrugën xxx, punëtor i xxx, të kryer shkollën e lartë, xxx dhe xxx, shqiptar i Kosovës;

i dënuar në shkallën e parë me një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim, me kusht për periudhë kohore tre (3) vjet, me Aktgjykimin me nr. 200/2010 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 28 Shkurt 2013, pasi që është shpallur fajtor për veprat penale të Mashtrimit në Detyrë sipas Nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me Nenin 23 (bashkë-kryerje) të KPK-së të 2004 (Pika 6 e Akuzës);

R.P., i biri i xxx dhe nënës xxx, i lindur më xxx në fshatin xxx, Komuna e Prishtinës, punëtor, me shkollë të lartë të kryer, xxx dhe xxx, shqiptar i Kosovës

i dënuar në shkallën e parë me një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim, me kusht për periudhë kohore tre (3) vjet, me Aktgjykimin nr. P200/2010 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 28 Shkurt 2013, pasi që është shpallur fajtor për veprat penale Mashtrimi në Detyrë sipas Nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me Nenin 23 (bashkë veprim) të KPK-së të 2004 (Pika 6 e Akuzës).

I.H., i biri i xxx dhe nënës xxx, i lindur më xxx në fshatin xxx, Komuna e Podujevës, xxx, me banim në xxx, xxx, me shkollë të lartë të kryer, xxx dhe xxx, shqiptar i Kosovës.

i dënuar në shkallën e parë me një (1) vit dhe gjashtë (6) muaj burgim, me kusht për një periudhë kohore tre (3) vjet, me Aktgjykimin nr. P200/2010 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 28 Shkurt 2013, pasi që është shpallur fajtor për veprat penale Mashtrimi në Detyrë sipas Nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me Nenin 23 (bashkë veprim) të KPK-së të 2004 (Pika 6 e Akuzës).

F.S., i biri i xxx dhe nënës xxx, i lindur më xxx në xxx, xxx, me banim në xxx, xxx, xxx i diplomuar, xxx dhe xxx, shqiptar i Kosovës.

i dënuar në shkallën e parë me një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim, me kusht për një periudhë kohore tre(3) vjet, me Aktgjykimin nr. P200/2010 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 28 Shkurt 2013, pasi që është shpallur fajtor për veprat penale Mashtrimi në Detyrë sipas Nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me Nenin 23 (bashkë veprim) të KPK-së të 2004 (Pika 6 e Akuzës).

R.S., i biri i xxx dhe nënës xxx, i lindur më xxx në fshatin xxx, komuna e Podujevës, xxx, me banim në xxx në rrugën xxx, xxx xxx xxx, xxx i diplomuar, xxx dhe xxx, shqiptar i Kosovës,

i dënuar në shkallën e parë me një (1) vit burgim, me kusht për periudhë kohore tre (3) vjet, me Aktgjykimin nr. P200/2010 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 28 Shkurt 2013, pasi që është shpallur fajtor për veprat penale Mashtrimi në Detyrë sipas Nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me Nenin 23 (bashkë veprim) të KPK-së të 2004 (Pika 6 e Akuzës).

Sh.H. i biri i xxx dhe nënës xxx, i lindur më datë xxx në fshatin xxx, komuna e Podujevës, xxx, me banim në fshatin xxx, xxx xxx, me shkollë të lartë të kryer, xxx dhe xxx, shqiptar i Kosovës.

*i dënuar në shkallën e parë me një (1) vit burgim, me kusht për një periudhë kohore tre (3) vjet, me Aktgjykimin nr. P200/2010 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 28 Shkurt 2013, pasi që është shpallur fajtor për veprat penale *Mashtrimi në Detyrë* sipas Nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me Nenin 23 (bashke veprim) të KPK-së të 2004 (Pika 6 e Akuzës).*

D.H. i biri i xxx dhe nënës xxx, i lindur më xxx në fshatin xxx, komuna e Podujevës, xxx, me banim në fshatin xxx, xxx xxx, xxx, me shkollë të lartë të kryer, xxx dhe xxx, shqiptar i Kosovës.

*i dënuar në shkallën e parë me një (1) vit burgim, me kusht për periudhë kohore tre (3) vjet, me Aktgjykimin nr. P200/2010 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 28 Shkurt 2013, pasi që është shpallur fajtor për veprat penale *Mashtrimi në Detyrë* sipas Nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me Nenin 23 (bashke veprim) të KPK-së të 2004 (Pika 6 e Akuzës).*

G.Z., i biri i xxx dhe nënës xxx, i lindur më datë xxx në fshatin xxx, komuna e Podujevës, xxx xxx, me shkollë të lartë të kryer, xxx dhe xxx, shqiptar i Kosovës.

*i dënuar në shkallën e parë me një (1) vit burgim, me kusht për periudhë kohore tre (3) vjet me Aktgjykimin nr. P200/2010 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 28 Shkurt 2013, pasi që është shpallur fajtor për veprat penale *Mashtrimi në Detyrë* sipas Nenit 341 (1) dhe (3) në lidhje me Nenin 23 (bashke veprim) të KPK-së të 2004 (Pika 6 e Akuzës).*

duke vepruar sipas ankesave të parashtruar kundër Aktgjykimit nr. P200/2010 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 28 Shkurt 2013, (tani e tutje Aktgjykim i kundërshtuar)

- Ankesa e Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës (tani e tutje PSRK) të parashtruar më datë 17.06.2013
- Ankesa e Avokatit Mbrojtës, B.T. dhe A.H. në emër të të pandehurit **B.G.**, të parashtruar më datë 17.06.2013,
- Ankesa e Avokatit Mbrojtës R.G. të parashtruar në emër të të pandehurit **N.V.**, të parashtruar më datë 18.06.2013,
- Ankesa e Avokates Mbrojtëse S.M. në emër të të pandehurit **M.S.**, të parashtruar më datë 18.06.2013.
- Ankesa e Avokatit Mbrojtës O.M. në emër të të pandehurit **R.P.**, të parashtruar më datë 21.06.2013,
- Ankesa e Avokates Mbrojtëse L.B.Y. në emër të të pandehurit **I.H.**, të parashtruar më datë 18.06.2013.
- Ankesa e Avokatit Mbrojtës H.L. në emër të të pandehurit **F.S.**, të parashtruar më datë 01.07.2013,
- Ankesa e Avokatit Mbrojtës E.Sh. në emër të të pandehurit **R.S.**, të parashtruar më datë 18.06.2013, si dhe ankesa e parashtruar nga i pandehuri R.S. më datë 18.06.2013,
- Ankesa e Avokatit Mbrojtës K.R. në emër të të pandehurit **Sh.H.**, të parashtruar më datë 18.06.2013
- Ankesa e Avokatit Mbrojtës Xh.R. në emër të të pandehurit **G.Z.**, të parashtruar më datë 18.06.2013

pas shqyrtimit të Mendimit të Prokurorit shtetëror të Apelit me nr. PPA/I nr. 256/2013 të datës 5 Nëntor 2013;

pas mbajtjes së seancës publike më datë 28 Prill 2014 në prani të të pandehurit dhe Prokurores Shtetërore të Apeleve të EULEX-it, Judit Eva Tatrai;

pas pleqërimit dhe votimit më datë 28 Prill 2014, 20 Qershor dhe 24 Korrik 2014;

në pajtim me Nenin 420 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale – Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26 (tani e tutje ‘KPPP’).

lëshon si në vijim, këtë

AKTGJYKIM DHE AKTVENDIM

1. Ankesa e parashtruar nga Prokurori Special më datë 17.06.2013 HIDHET POSHTË si e PAPRANUESHME

2. Sa i përket të pandehurit B.G.

A. Dënimi i tij për Pikën 2 të Akuzës – Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit **anulohet** dhe akuza **hidhet poshtë**.

B. Dënimi i tij për Pikën 6 – Mashtrimi në Detyrë në bashkë kryerje me të pandehurin **N.V. vërtetohet**; sidoqoftë baza ligjore për akuzë dhe dënimi ndryshon në bazë të Nenit 33, Nenit 120, paragrafit 2 dhe Nenit 426, paragrafit 2 të KPK-së deri në masë që dënimi të mbështetet në pjesëmarrjen e të pandehurve **MS., R.P., I.H., F.S., R.S., Sh.H., G.Z.** dhe **D. H.**, të cilët kolegji i shpallë se kanë dhënë “ndihmë” e jo “bashkë kryerje”

C. Dënimi i tij për të paguar shpenzimet **anulohet**

D. Dënimi i ti me burgim **ndryshon** në 3 vjet

E. Përveç ndryshimit të më sipërm, dënimi i tij **vërtetohet** në çdo aspekt

3. Sa i përket të pandehurit N.V.:

A. Dënimi i tij për Pikën 2 – Shpërdorim i Pozitës Zyrtare **anulohet** dhe akuza **hidhet poshtë**.

B. Dënimi i tij për Pikën 6 – Mashtrimi në Detyrë në bashkë kryerje me të pandehurin **B.G. vërtetohet**; sidoqoftë baza ligjore për akuzë dhe dënim ndryshon në bazë të Nenit 33 dhe Nenit 120, paragrafit 2 dhe Nenit 426, paragrafit 2 të KPK-së deri në masë që dënimi të mbështetet në

pjesëmarrjen e të pandehurve **M.S., R.P., I.H., F.S., R.S., Sh. H., G.Z.** dhe **D.H.**, të cilët Kolegji i shpallë në bazë të “ndihmës” e jo “Bashkëkryerjes”.

C. Anullohet dënimi për të paguar shpenzimet

D. Dënimi i tij me burgim **ndryshohet** në 3 vjet.

E. Përveç ndryshimeve si më sipër, **vërtetohet** dënimi i tij në çdo aspekt

4. Sa i përket të pandehurve M.S., R.P., I.H., F.S., FIFAT SADIKU, SHEMSI HALITI, G.Z., and DRITON HAMITI:

A. Anullohet secili dënim i tyre sa i përket Pikës 6 të Akuzës, Mashtrim në Detyrë në bashkë kryerje

B. Secili nga të pandehurit shpallet **fajtor** të ndihmës në Mashtrim në Detyrë në shkelje të Nenit 33, Nenit 120, paragrafit 2 dhe Nenit 426, paragrafit 2 të KPK-së sepse në data të ndryshme, ndërmjet 1 Janarit dhe 31 Dhjetorit 2006, secili i pandehur me qëllim ka ndihmuar të pandehurin **B.G., xxx xxx dhe më vonë xxx për xxx dhe xxx**, si dhe të pandehurin **N.V.**, Drejtues i xxx në xxx për xxx dhe të xxx, të dy duke vepruar si persona zyrtar dhe në bashkë kryerje në veprat penale të përshkuara më sipër, duke vepruar si xxx dhe xxx të kompanive xxx, në veçanti **M.S.** si xxx dhe xxx i kompanisë së vete xxx xxx xxx dhe xxx; **R.P.**, si xxx dhe xxx i kompanisë xxx xxx xxx dhe xxx; **I.H.**, xxx dhe xxx i kompanisë xxx xxx; **F.S.**, xxx dhe xxx i kompanisë xxx xxx xxx; **Sh.H.**, xxx dhe xxx i kompanisë xxx xxx; **G.Z.**, xxx dhe xxx i kompanisë xxx xxx; si dhe **D.H.**, xxx dhe xxx i kompanisë xxx xxx, duke ndihmuar në mashtrimin e zyrës përgjegjëse të xxx duke prezantuar kontrata të rrejshme për punë që kurrë nuk janë kryer e që nuk ishte kontraktuar për punë e që nuk është kontraktuar siç është cekur më sipër.

C. Anullohet dënimi i secilit të pandehur për të paguar shpenzimet.

D. Sa i përket të pandehurve **M.S., R.P., I.H. dhe F.S.**, dënimet e tyre **reduktohen** në 1 vit e 4 muaj burgim, me kusht për 3 vjet.

E. Sa i përket të pandehurve **R.S., Sh. H., G.Z. dhe D. H.**, dënimet e tyre reduktohen në 10 muaj burgim, me kusht për 3 vjet

F. Sa i përket të pandehurit **R.P.**, në përputhje me Nenin 365 të KPK-së, 10 ditë që kanë kaluar në paraburgim, i **përlllogaritet** në dënimin e tij.

Përveç ndryshimeve të veçanta nga kjo Gjykatë, Aktgjykimi i Gjyqit konfirmohet në të gjitha aspektet

SFONDI PROCEDURAL

Rasti aktual përfshin një skemë në xxx dhe të xxx ku fondet e ndërtimit dhe të renovimit të shtëpive për të xxx pas konfliktit të armatosur në 1999, të cilat në mënyrë sekrete janë ridrejtuar

në projekte tjera të ndërtimit nëpërmjet përdorimit të kontratave dhe dokumenteve të ndryshme të rrejshme.

Më datë 6 Gusht 2010, PSRK-ja ka ngritur Aktakuzë me nr. PP 58/2010 në Gjykatën e atëhershme të Qarkut në Prishtinë. Aktakuza është ndritur kundër të gjithë të pandehurve të sipër përmendur për veprat penale të Përvetësimit Gjatë Ushtrimit të Detyrës, të kryer në bashkë kryerje (Pika 1 e Akuzës), Përvetësimit, të kryer në bashkë-kryerje (Pika 2 e Akuzës), Mashtrimi në Detyrë, të Kryer në bashkë kryerje (Pika 3 e Akuzës), kundër të pandehurve **N.V.** për Marrje të Ryshfetit (pika 4 e Akuzës), kundër të pandehurit **R.P.** për Dhënien e Ryshfetit (Pika 5 e Akuzës); si dhe kundër të gjithë të pandehurve të përmendur më sipër, përveç të pandehurve **S.P.** dhe **B.G.** për Falsifikim të Dokumenteve Zyrtare, të kryer në bashkë kryerje (Pika 6 dhe 7 e Akuzës).

Aktakuza u konfirmua në tërësi me Aktvendimin e Gjyqtarit të Konfirmimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, KA, nr. 185/2010 të datës 7 Shkurt 2011.

Shqyrtimi kryesor filloi më datë 18 Nëntor 2011 dhe vazhdoi në 39 seanca gjatë vitit 2012 dhe në fillim të vitit 2013.

Më datë 9 Dhjetor 2011, PSRK-ja ngriti një Aktakuzë të Ndryshuar me nr. 58/2010 në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës kundër të gjithë të pandehurve të sipër përmendur përveç të pandehurit **N.V.** për veprën penale Përvetësim Gjatë Ushtrimit të detyrës, të kryer në bashkë kryerje (Pika 1 e Akuzës); kundër të gjithë të pandehurve të sipër përmendur për Shpërdorim, të kryer në bashkë kryerje (Pika 2 e Akuzës), Mashtrim në Detyrë, të kryer në bashkë kryerje (Pika 3 e Akuzës); kundër të pandehurit **N.V.** për Marrje të Ryshfetit (Pika 4 e Akuzës); kundër të pandehurit **R.P.** për dhënie të Ryshfetit (Pika 5 e Akuzës); kundër të gjithë të pandehurve të sipër përmendur për Falsifikim të Dokumenteve Zyrtare, të kryer në bashkë kryerje (Pika 6 dhe 7 e Akuzës).

Më 13 Prill 2012, PSRK-ja ngriti Aktakuzën e Dytë të Ndryshuar me nr. PP 58/2010, kurse më datë 21 Nëntor 2012 Aktakuzën e Tretë të Ndryshuar me nr. 58/2010, në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës. Aktakuzë e Tretë e Ndryshuar e ngarkonte të pandehurin **S.P.** me veprën penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose të Autorizimit (Pika 1 e Akuzës); të pandehurit **S.P.** dhe **B.G.** me veprën penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare dhe të Autorizimit, të kryer në bashkë kryerje (Pika 2 e Akuzës); të pandehurin **N.V.** me veprën penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare dhe të Autorizimit (Pika 3 e akuzës); të gjithë të pandehurit e sipër përmendur me veprën penale të Përvetësimit gjatë Ushtrimit të Detyrës, të kryer në bashkë kryerje (Pika 4 e Akuzës); Shpërdorim, të kryer në bashkë kryerje (Pika 5 e Akuzës), Mashtrimi në Detyrë, të kryer në bashkë kryerje (Pika 6 e Akuzës); i pandehuri **N.V.** me veprën penale e Marrjes së Ryshfetit (Pika 7 e Akuzës), i pandehuri **R.P.** për veprën penale të Dhënies së Ryshfetit (pika 8); të gjithë të pandehurit e sipër përmendur me veprën penale të Falsifikimit të Dokumenteve Zyrtare dhe Falsifikimit të Dokumenteve, të kryer në bashkë kryerje (Pika 9 dhe 10).

Më datë 19 Shkurt 2013, gjatë fjalës përmbyllëse që ia paraqiti Gjykatës, Prokurori Special tërhoqi akuzën e dhënies së ryshfetit kundër **R.P.** (Pika 8) dhe Falsifikimin e Dokumenteve Zyrtare dhe Falsifikimin e Dokumenteve kundër të gjithë të pandehurve të sipër përmendur (Pika

9 dhe 10) për shkak të skadimit të periudhës së parashkrimit absolut, si dhe akuzën e Marrjes së Ryshfetit kundër të pandehurit **N.V.** (Pika 7) në mungesë të provave.

Gjykata Themelore e Prishtinës shpalli Aktgjykimin me nr. P200/2010 më datë 28 Shkurt 2013, Trupi Gjykues ka hedhur poshtë akuzat nën pikën 7, 8, 9 dhe 10 sipas Nenit 389 (1) të KPPK-së sepse Prokurori Special ka tërheqë këto akuza në përfundim të shqyrtimit kryesor. Të gjithë njëmbëdhjetë të pandehurit e sipër përmendur u liruan sa i përket akuzës së Përvetësimit gjatë Ushtrimit të Detyrës (pika 4) dhe Shpërdorimit (Pika 5).

I pandehuri **S.P.** lirohet nga të gjitha akuzat me të cilat ngarkohet (Pika 1, 2 dhe 6)

I pandehuri **B.G.** ishte shpallur fajtor për veprat penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare dhe të Autorizimit (Pika 2) dhe në bashkëkryerje të Mashtrimit në Detyrë (Pika 6). U dënua me dy vjet burgim lidhur me Pikën 2 dhe tre vjet burgim lidhur me Pikën 6 me dënim unik katër vjet burgim. Si dënim plotësues, i pandehuri **B.G.** iu ndalua të ushtrojë **xxx dhe në xxx** për dy vjet.

I pandehuri **N.V.** ishte shpallur fajtor për veprën penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare dhe të Autorizimit (pika 3) dhe në bashkë kryerje të Mashtrimit në Detyrë (Pika 6). I pandehuri u dënua me dy vjet burgim lidhur me Pikën 3 dhe 3 vjet burgim lidhur me Pikën 6, me një dënim unik tre vjet e gjashtë muaj burgim. Si dënim plotësues, i pandehuri **N.V.** iu ndalua ushtrimi i funksioneve në shërbimet publike dhe në administratën publike për dy vjet.

Të pandehurit **M.S., R.P., I.H., F.S., R.S., SH.H., G.Z.** dhe **D.H.** u shpallën fajtor për veprat penale në bashkë kryerje të Mashtrimit në Detyrë.

Të pandehurit **M.S., R.P., I.H. dhe F.S.** u dënuan me një vit dhe gjashtë muaj burgim, me kusht për tre vjet. Të pandehurit **R.S., Sh.H., G.Z. dhe D.H.** u dënuan me një vit burgim, me kusht për tre vjet.

Gjykata Themelore kërkon që të gjithë të pandehurit të rimbursojnë shpenzimet e procedurës në shumë të përcaktuar 3000 EUR.

Aktgjykimi i kundërshtuar u ankimua nga ana e PSRK-së dhe të gjithë të pandehurve, përveç të pandehurit **D.H.**

Gjykata e Apelit mbajti seancën publike në këtë çështje më datë 28 Prill 2014 në prani të të pandehurve dhe Prokurori Shtetëror i Apelit. I pandehuri **M.S.** ishte ftuar në mënyrë të duhur për seancë, por nuk ishte i pranishëm. Kolegji i Apelit vazhdoi me procedurë në mungesë në pajtim me Nenin 410 (4) të KPPK-së.

GJETJET E GJYKATËS SË APELIT

1. Kompetenca e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur mbi Apelin në pajtim me nenin 17 dhe nenin 18 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr. 03 / L-199).

Kolegji i Gjykatës së Apelit është i përbërë në pajtim me nenin 19 paragrafi (1) të Ligjit për Gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit për juridiksionin, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve të EULEX-it dhe prokurorëve në Kosovë (Ligji nr. 03 / L-053). Palët nuk paraqitën ndonjë kundërshtim kundër përbërjes së kolegjit.

2 Ligji i aplikueshëm procedural – *mutatis mutandis* Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), në fuqi deri më 31.12.2012

Ligji procedural penal i zbatueshme në çështjen penale përkatëse është KPPK që mbeti në fuqi deri më 31 dhjetor 2012.¹ Interpretimi i drejtë i dispozitave kalimtare të Kodit të Procedurës Penale (KPP), në fuqi që nga 1 janar 2013, përcakton se në procedurën penale që janë inicuar para hyrjes në fuqi të Kodit të ri, për të cilën gjykimi ka filluar tashmë, por nuk ka marr formë të prerë, dispozitat e KPPK do të zbatohen sipas parimit *mutatis mutandis* derisa vendimi merr formë të prerë. Referenca në këtë drejtim i është bërë opinionit ligjor nr. 56/2013 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të miratuar në seancën e saj të përgjithshme më 23 Janar 2013.

ARSYETIMI

HYRJE

Ky rast është gjykuar në bazë të dispozitave të Kodit të ish Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) dhe përfshin një skemë në xxx për xxx, ku fondet për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive për të xxx pas luftës janë drejtuar fshehurazi për projekte të tjera të ndërtimit nëpërmjet përdorimit të kontratave të ndryshme të rreme dhe dokumenteve të tjera.

Gjykata gjeti se **z.P., z. G.** dhe **z. V.** ishin xxx, respektivisht xxx (dhe më vonë xxx) dhe xxx i xxx të xxx për xxx. Gjykata më tej konstatoi se secili nga të pandehurit e tjerë kanë qenë të përfshirë në biznesin e xxx, duke bërë punë të xxx të drejtuar nga xxx.

Gjykata gjeti se **z.V.** si xxx i xxx, keqpërdori pozitën e tij zyrtare, duke hartuar dhe nënshkruar kontratat për renovime dhe rindërtime të shtëpive të të xxx pa specifikuar emrat e të xxx apo adresat e punës që duhej kryer dhe pastaj duke drejtuar punën që të kryhet në projekte të ndryshme jo brenda fushëveprimit të punës së Ministrisë.

Gjykata gjeti më tej se **z. G.**, si xxx i xxx, udhëzoi njerëz të ndryshëm për të nënshkruar raportet e rreme të inspektimit që tregonin se puna ishte kryer kur në fakti ishte ndryshe, punë tjetër ishte bërë, duke fshehur këtë fakt. Këto raporte të rreme të inspektimit pastaj formuan bazën për shpërndarjen e parave njerëzve që bënin punën aktuale të ndërtimit.

¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës – Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26, në fuqi që nga data 06.04.2004 deri më datë 31.12.2012

Së fundi, gjykata gjeti se të pandehurit e mbetur ishin xxx të xxx xxx ose punëtorë të xxx që në fakt kryen punën. Gjykata gjeti se të gjithë, përveç njërit nënshkruan dokumente të rreme në lidhje me vendet ku janë kryer punimet. Një i pandehur nuk i nënshkroi të gjitha kontratat, por ato që nuk u nënshkruan nga ai, i nënshkroi vëllai i tij në emër të kompanisë me dijeni dhe pëlqim të tij. Sa për koston e punës së kryer, vazhdimisht copëtohej në pagesa të shumta në shumë më pak se 10,000 euro, në mënyrë që një verifikim më i vogël do t'i kushtohej faturimeve para se të autorizohet pagesa.

ANKESAT

Në lidhje me **z. H.**, i cili nuk ka paraqitur ankesë, dhe të gjithë të pandehurit e tjerë, gjykata do të zbatojë dispozitat e nenit 419 e cila thekson:

"Në qoftë se pas ankesës gjykata e shkallës së dytë konstaton se arsyet të cilat vendosën atë vendim në favor të të akuzuarit, dhe të cilat nuk janë të natyrës personale, janë edhe në të mirë të të bashkakuazuarit që nuk ka paraqitur ankesë ose nuk e ka paraqitur një ankesë në të njëjtën linjë, gjykata do të procedojë sipas detyrës zyrtare sikurse një ankesë e tillë të ishte paraqitur nga bashkë-akuzuarit. "

Kështu, gjatë gjithë këtij mendimi, gjykata do t'i referohet "të gjithë operatorëve ekonomik" sikur Z. Hamiti të kishte ka paraqitur ankesë dhe do të merret me të gjitha çështjet sikur të kishin qenë të gjitha të ngritur nga secili i pandehur.

Para se të kthehemi në disa nga një morie të çështjeve të ngritura nga palët në ankesë, gjykata ka nevojë për të trajtuar çështjen e pranueshmërisë së ankesës së prokurorisë dhe ankesën e të pandehurit **F.S.**

Pranueshmëria e Ankesës së Prokurorit

Zyra Speciale e Prokurorisë së Kosovës (PSRK) ka paraqitur ankesë në këtë çështje duke ngritur vetëm çështjen e lirimimit të të pandehurit **P.** Në shqyrtimin e ankesës Prokurori Apelit theksoi se të dhënat e gjykatës nuk reflektojnë ndonjë "njoftim" të qëllimit për të apeluar nga ana e prokurorit të gjykimit në kohën e shpalljes së gjykimit dhe as një "njoftim" me shkrim brenda tetë ditë pas kësaj, siç kërkohet me Nenin 400 (1) (KPPK). Neni 400 (2) parashikon se në qoftë se një palë nuk arrin të bëjë njoftimin e kërkuar në një nga dy mënyrat e lejuara sipas Nenit 400 (1) se pala është, "... konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e ankimit ..."

Prokurori i Apelit, në një shënim (fusnotë), tregoi gjithashtu se e kishte kontaktuar Prokurori i PSRK-së dhe (ajo) i kishte thënë se kur kryetari i trupit gjykues kërkoi nga palët që të shpallin synimin e tyre për të apeluar ajo "kishte pohuar me tundje të kokës". Prokurori Ankimues i PSRK-së nuk ka kërkuar të dhëna plotësuese në këtë rast për të dhënë dëshmi të këtij gjesti të tundjes së pretenduar me kokë. Shih nenin 401 (4).

Ky panel, duke vepruar në përputhje me nenin 409 (4), kërkoi një raport nga gjyqtarët e trupit gjykues, procesmbajtësi dhe përkthyesi nëse u kujtohet së këta pjesëmarrës kanë në lidhje me

këtë çështje. Katër nga pjesëmarrësit raportuan se nuk iu kujtohen ngjarjet përkatëse dhe së pesti, ndërkohë që nuk iu kujtohet diçka në veçanti, ishte "Përshtypja" e tij se atë kohë, në një masë "pothuajse 50% të saktësisë" që prokurori i rastit dukej i kënaqur me rezultatin

Neni 400 (1) nuk përshkruan ndonjë metodë të veçantë me të cilën "shpallja" e kërkuar e ankesës duhet të shprehet në kohën e shpalljes së aktgjykimit. Megjithatë, është e qartë se është barrë e palës që dëshiron të apelojë për të bërë një formë të "njoftimit", që mjafton në mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje të sjellë në vëmendje të gjykatës qëllimin dhe për të siguruar përfshirjen e saj në procesverbal.

Duke supozuar, pa vendosur se prokurori i rastit e bëri në fakt "lëkundjen me kokë" kur Kryetari i Trupit Gjykses ftoi që të shpallen synimet për të apeluar, prokurorja do të duhej të ishte e kujdesshme që në kuadër të dispozitave të nenit 350 (2) të verifikojë të dhënat e finalizuar të procedurave për të siguruar se "shpallja" e saj është konstatuar në procesverbal.

Duke pasur parasysh si më sipër, dhe në bazë të nenit 420 (1) 1), Kolegji konstaton se ankesa e paraqitur nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK) është e papranueshme dhe nuk do të merret parasysh.

Pranueshmëria e Ankesës së të pandehurit F.S.

Faktet në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së kësaj ankese janë shumë të ngjashme me ato që posa u trajtuan në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së ankesës së prokurorisë. Nuk ka asnjë tregues të konstatuar të ndonjë "shpalljeje" të qëllimit të ankimit nga ky pandehuri në kohën e shpalljes së aktgjykimit e as një njoftimi me shkrim brenda tetë ditësh nga dita e gjykimit. I vetmi shpjegim për këtë ishte thjesht një deklaratë nga ana e avokatit të z Sadiku në kohën e argumentit përballë kolegjit. Në atë kohë avokati deklaroi se në përgjigje të kërkesës së kryetarit të trupit gjykses se "bëri me dorë dhe tundi kokën."

Nuk ka nevojë për të përsëritur analizën dhe arsyetimin e paraqitur më lart për të gjetur veprimet e avokatit në mënyrë të qartë si të pamjaftueshme siç është "pohimi me tundjen e kokës" nga ana e prokurorit. Megjithatë, pavarësisht "njoftimit" në mënyrë të pamjaftueshme të avokati, rezultati për **z. S.** është ndryshe.

Dispozita e heqjes dorë nga ankesa në Nenin 400 (2) ka një përjashtim që është gjetur në nenin paragrafin (4). Aty, në qoftë se pala nuk arrin të "shpallë" dhe është dënuar me burg, heqja dorë nga ankesa sipas nenit paragrafit (2) nuk ndodh. Në këtë rast **z. S.** është dënuar me një vit e gjashtë muaj burg, me kusht për tre vjet. Ndërsa nenin paragrafi (4) të Statutit nuk trajton çështjen e dënimit me kusht, Kolegji e konsideron se meqë i pandehuri përballë potencialisht të vuaj dënimin e shqiptuar, arsyeja për përjashtim zbatohet në mënyrë të barabartë me burgim të pezulluar.

Duke marr parasysh si më sipër, Kolegji e konsideron se ankesa e **F.S.** është e pranueshme dhe do të merret parasysh

VLERËSIMI I PROVAVE

Secili nga të pandehurit ka sfiduar aspekte të ndryshme të gjetjeve ligjore dhe faktike dhe arsyetimin e trupit gjykues. Kjo Paneli I ka shqyrtuar me kujdes të gjitha këto sfida.

Gjykata e Apelit të Kosovës shpesh ka aplikuar parimin e përgjithshëm se është e nevojshme për të dhënë një shkallë të konsiderueshme të respektit gjetjeve të faktit të trupit gjykues meqë ka dëgjuar provat dhe është në pozitë më të mirë për të vlerësuar peshën dhe vlerën e saj². Përveç kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës është shprehur se kjo duhet, "... të lëshojë pe ndaj vlerësimit të trupit gjykues për besueshmërinë e dëshmitarëve të gjykimit, të cilët u paraqitën personalisht përballë tyre dhe që dëshmuuan personalisht përballë tyre. Nuk është me vend që Gjykata Supreme e Kosovës të shkelë mbi vlerësimin e Trupit Gjykues sa i përket besueshmërisë së këtyre dëshmitarëve nëse nuk ka një bazë të shëndoshë për të bërë këtë". Gjykata vazhdoi duke thënë se standardi që duhesh zbatuar ishte" ... për të mos shqetësuar gjetjet e gjykatës së shkallës së parë, përveç nëse provat mbi të cilat mbështetet gjykata nuk mund të ishin pranuar nga ndonjë gjykatë e faktit, ose ku vlerësimi i saj ka qenë tërësisht i gabuar. "³

Këtu është e qartë se trupi gjykues ka analizuar në mënyrë të arsyeshme dhe ka peshuar provat duke përfshirë secilin dhe të gjithë të pandehurit. Duke pasur parasysh shqyrtimin e provave nga trupi gjykues dhe shpjegimin e tyre në përgjithësi të qartë të arsyeve të tyre për gjetjet e tyre, *me përjashtim të, siç tregohet në aspekte të veçanta të këtij opinioni të përcaktuar më poshtë*, gjykata pranon konstatimet faktike dhe arsyetimin e trupit gjykues.

ÇËSHTJET QË AFEKTOJNË SHUMË TË PANDEHUR

Dispozitivi nuk bënë gjetje specifike të përfitimit material që i atribuohet secilit të pandehur.

Në dispozitiv të aktgjykimit trupi gjykues bëri gjetjen e përgjithshëm se të pandehurit e ndryshëm, me anë të veprimeve të tyre kriminale, kanë marr përfitime materiale që tejkalojnë 5000 €, shuma të përcaktuara në nenet përkatëse të kodit penal që përcaktojnë nivelet e ndryshme të dënimit. Trupi gjykues nuk ka bërë një konstatim të veçantë në dispozitiv, si për sasinë aktuale të përfitimeve materiale të fituara nga çdo i pandehur. Këto shuma kanë të bëjnë me të pandehurit **M.S., R.P., I.H., F.S., R.S., Sh.H., G.Z. dhe D. H.** janë përcaktuar nga trupi gjykues dhe të përcaktuara në Paragrafin IV dhe Nen paragrafin 1b "fakte të tjera relevante të dëshmuara gjatë gjykimit" në faqen 47 të versionit në gjuhën angleze të Aktgjykimit.

Sa i përket të pandehurve **G. dhe V.**, trupi gjykues konstaton në paragrafin IV nën paragrafin 1a, "fakte relevante në aktakuzë që konsiderohen se janë dëshmuar" në faqen 45 të versionit në gjuhën angleze të Aktgjykimit, se secili prej tyre kishte vepruar së bashku dhe së bashku me të gjithë operatorët ekonomik për të kryer veprën penale Mashtrimi në Detyrë. Kështu gjykata gjeti domosdoshmërisht të pandehurit **G. dhe V.** përgjegjëse për të gjitha të mirat materiale të paligjshme të fituara nga operatorët ekonomik në shumën totale prej € 422.502.85.

² Shih për shembull, Gjykata e apelit të Kosovës, PAKR 1121/12, 25 Shtator 2013, para.48

³ Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 Dhjetor 2009, paragrafi 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 Shtator 2012, paragrafi 30.

Gjykata konstaton se dispozitivi duhet të përmbajë vetëm gjetjen se aktivitetet e paligjshme të të akuzuarve kanë prodhuar një përfitim prej më shumë se 5,000 €, dhe ky është një element që përcakton seriozitetin e veprës. Gjetjet e kolegjit përveç dispozitivit, në lidhje me sasinë e vërtetë të përfitimit të paligjshëm, ka rëndësi vetëm sa i përket ashpërsisë së dënimit dhe kthimit të mundshëm.

Dijenja dhe qëllimi i Operatorit Ekonomik për të kryer veprën penale

Në gjykim dhe në apel, të gjithë operatorëve ekonomik pretendojnë se nuk kanë pasur ndonjë qëllim për të marrë pjesë në ndonjë lloj të veprimtarisë kriminale. Ata të gjithë në thelb pretendojnë se mendonin se **xxx**-ja kishte mënyrën e vete për të bërë gjërat dhe se duhej të ndiqnin këtë proces në mënyrë që të paguhen për punën e tyre. Duke pasur parasysh provat që ata ose kishin nënshkruar faturat me të cilat pohonin se kishin kryer punën, të cilën ata e dinin se nuk e kishin kryer dhe për më tepër hartuan fatura në mënyrë që të mbajnë shumicën e pagesave nën 10,000 Euro, (ose ishin në dijeni për këtë dhe pranuan), trupi gjykues do të kishte qenë tepër naiv po të kishte besuar se këta të pandehur nuk ishin në dijeni se ishin duke marrë pjesë në një lloj skeme të paligjshme që nënkupton marrjen e pagesave nga MKK. Nuk është e domosdoshme se ishin në dijeni të natyrës së saktë të skemës për sa kohë që ata e dinin se ata ishin duke ndihmuar skemë të paligjshme për pagesa. Provat në mënyrë të qartë dëshmuar se operatorët ekonomik kishin për qëllim për të marrë pjesë në skemën kriminale.

I pandehuri M.S.

Ky i pandehur pohon se nuk ka nënshkruar kontratat Nr.12138, 12140 dhe 12141. Gjersa kjo duket se është e vërtetë, këto tri kontrata ishin vetëm tri në kuadër të një sërë të kontratave për punë të kryeshin nga kompanitë e të pandehurve. Të pandehurit në mënyrë të qartë në këtë deklaratë tek hetuesit se në mënyrë aktive ka marr pjesë në falsifikimin e faturave për kontratat të ndryshme në mënyrë që kompania e tij të paguhej. Ai më tej deklaroi se ishte në dijeni se vëllai i tij kishte nënshkruar këto kontrata në emër të kompanisë si pjesë e kësaj skeme mashtruese që në mënyrë të drejtë për drejtë përfitonin kompanitë e të pandehurve dhe në këtë mënyrë përfitoi personalisht. Ai i pohoi të gjitha këto deklaratat gjatë gjykimit. Këto prova mjaftojnë që të pandehurit të jenë penalisht përgjegjës në këto kontrata si dhe të tjerat të cilat ai personalisht i nënshkroi.

Mashtrimi në Detyrë in bashkë kryerje

Të gjithë të pandehurit, përveç **P.** u dënuan për Pikën 6 të Aktakuzës të akuzuar me Mashtrim në Detyrë në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 23, nenin 107 paragrafi 1 dhe neni 341, paragrafët 1 dhe 3 të kodit të mëparshëm penal. Çështjet përballë Trupit Gjykues, duke zbatuar kodin r vjetër, janë: 1) cilat janë kualifikimet ligjore për të qenë në gjendje për të kryer këtë krim në bashkëkryerje dhe 2) cili nga të pandehurit e dënuar përmbushin këto kualifikime ligjore?

Në këtë rast, gjykata konstatoi se të pandehurit **G. dhe V.** ishin secili "person zyrtar" në **xxx për xxx dhe xxx (xxx)**, si duket ata ishin "emëruar në një organ publik", siç parashikohet në nenin 107 paragrafi 1. Gjykata gjeti se tetë të pandehurit tjerë ishin të gjithë kontraktues të **xxx** apo të angazhuar në punën e **xxx** dhe që në fakt kryenin punë që krijoi bazën për akuza. Në aktgjykim

tetë të pandehurit janë të në mënyrë kolektive përmenden si "operatorët ekonomikë" dhe se kjo terminologji do të përdoret edhe këtu.

I Pandehuri V. ka sfiduar konstatimin e të qenurit "person zyrtar" në apel, duke pretenduar se provat vetëm që treguan se ai ishte thjesht një nëpunës civil dhe jo një "personi zyrtar", siç përcaktohet me ligj. Kjo gjykatë ka shqyrtuar me kujdes provat dhe përfundimet dhe arsyetimin nga ana e trupit gjykues në këtë çështje. Bazuar në këtë shqyrtim kjo gjykatë konstaton se konstatimet e trupit gjykues mbi faktin dhe arsyetimi ishin në tërësi të arsyeshme dhe përfundimi i tyre se i pandehuri V. ishte një "person zyrtar" nuk do të çregullohet në apel.

Operatorët ekonomik si persona zyrtar

Pyetja e radhës që duhet të adresohet është nëse secili operatorë ekonomik ishin "person zyrtar" sipas kodit të vjetër. Në qoftë se ata nuk ishin "personi zyrtar", atëherë çështja nëse janë apo jo person i cili nuk është "person zyrtar" mund të veprojë në bashkëkryerje me një "person zyrtar" lind ku krimi i supozuar është Mashtrimi në Detyrë.

Mashtrimi në Detyrë mund të kryhet vetëm nga "personi zyrtar", sipas dispozitave të nenit 341 (1

"Një person zyrtar i cili, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore ... duke paraqitur një deklaratë të rreme të llogarisë, ose në ndonjë mënyrë tjetër mashtron një person të autorizuar për të bërë një pagesë të paligjshme do të dënohet ..."

Në këtë rast, prokuroria akuzon se **G. dhe V.**, secili si "person zyrtar" në xxx, kanë kryer këto krime, si pjesë e një skeme mashtruese që domosdoshmërisht kërkonte veprime të padrejta të "operatorëve ekonomik" për të kryer atë.

Termi "person zyrtar" është përcaktuar në nenin 107 (1) të kodit të mëparshëm. Neni, në pjesë përkatëse, deklaron:

(1) Termi "person zyrtar" do të thotë:

1) Personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ publik;

2) Personi i autorizuar në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili me ligj apo me dispozitë tjetër nxjerrë në pajtim me ligjin, ushtron autoritet publik, dhe që brenda këtij autoriteti ushtron detyra të posaçme;

3) Një person i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të parashikuara me ligj "

Duket qartë se operatorët ekonomikë nuk kualifikohen për të qenë "person zyrtar" sipas nenit (1) 1) meqë është e qartë se ata nuk janë të zgjedhur ose të emëruar në një njësi publike.

Duke shikuar Paragrafin (1) 2) ekziston një mungesë e vërtetë e qartësisë sa i përket numrit të termave të përdorura. Pavarësisht mungesës së qartësisë një frazë kyçe duket të përjashtojë operatorët ekonomik. Frazja, "ushtrimi i autoritet publik" në duket se përjashton operatorët

ekonomik. Si zyrtarë të bizneseve të tyre përkatëse ata sigurisht së ushtrojnë autoritet në bizneset e tyre, por është e vështirë të shihet se si do të ishte kjo autoritet "publik". Kjo duket veçanërisht e qartë kur shikon rolin e "personave zyrtarë" që janë përmendur në të gjithë pjesët e tjera të këtij neni. Për shembull: personat e zgjedhur ose të emëruar në njësi publike; Personeli i UNMIK-ut apo KFOR-it; personat në organizatat ndërkombëtare ose mbi kombëtarë; dhe gjyqtarë apo prokurorë në një gjykatë ndërkombëtare.

Si me dy seksionet e mëparshme, duket se nuk ka gjasa që neni (1) 3) aplikohet për të bërë operatorët ekonomik "person zyrtar". Analiza është shumë e njëjtë si më sipër. Kur e shikon rolet që janë përmendur gjatë gjithë këtij neni, të tilla si: personat e zgjedhur ose të emëruar në njësi publike; personeli UNMIK-ut apo KFOR personelit; personat në organizatat ndërkombëtare ose mbi kombëtarë; dhe gjyqtarë apo prokurorë në një gjykatë ndërkombëtare, është e vështirë të shihet se si pronar i një biznesi privat të ndërtimit mund të ketë qenë i parashikuar të mbulohet nga kjo.

Nga kjo si më sipër, arrijmë në përfundimin se asnjë nga operatorët ekonomik kualifikohen si "persona zyrtar". Kjo, megjithatë, nuk është fundi i analizës. Ky përfundim ngre pyetjen nëse dikush i cili nuk është "person zyrtar" mund të kryejë krimin e Mashtrimi në Detyrë "në bashkëkryerje" me atë që është "person zyrtar".

Bashkë kryerje në mes të Presonit zyrtar dhe atyre të cilët nuk janë persona zyrtar

Për përgjigjen në pyetjen më sipër neve i drejtohem Neni 107 (3) të kodit të vjetër:

“Kur një person zyrtar ... përshkruhet si kryes i një veprë penale, të gjithë personat e përmendur në paragrafët 1 dhe 3 të Neni aktual mund të jenë kryes të veprave të tilla penale, në qoftë se nuk vijon nga elementet e veprës penale që kryesi mund të jetë vetëm njëri nga ata personat.”

Kështu, ne duhet të shikojmë elementet e veprave penale të Mashtrimi në Detyrë për të parë nëse vepra mund të kryhet në bashkë kryerje nga dikush që nuk është një "person zyrtar." Përgjigja është e qartë, "jo". Neni 341 ka si element bazë të krimit që personi që kryen krimin duhet të jetë një "person zyrtar". Meqë kemi konstatuar se asnjë nga operatorët ekonomik nuk janë "person zyrtar", ata nuk mund të kryejnë krimin e Mashtrimit në Detyrë. Meqë ligjërisht nuk janë në gjendje që personalisht të kryejnë këtë krim, nuk mund ta kryejnë atë në bashkëkryerje sipas neni 341 të kodit të mëparshëm. Megjithatë, ky nuk është fund i diskutimit.

Veprimtaritë tjera penale të Operatorëve ekonomik.

Pasi që konstatoam se operatorët ekonomik nuk mund të jenë fajtorë për Mashtrim në Detyrë në bashkë kryerje sipas kodit të mëparshëm, me këtë nuk përfundon diskutimin lidhur me përgjegjësisë potenciale të këtij grupi. Neni 386 (2) në mënyrë specifike tregon se gjykata nuk është e lidhur me klasifikimin ligjor të veprave të përshkuara në aktakuzë nga prokurori.

Neni 25 krijon përgjegjësi penale për ndihmën e qëllimshme në kryerjen e veprës penale.

“(1) Kushdo që qëllimisht ndihmon një pëson tjetër në kryerjen e veprës penale, do të dënohet siç parasheh Neni 65 (2) i Kodit aktual”

“(2) Ndihma në kryerjen e një vepre penale përfshinë dhënien e këshillës ose udhëzimin se si të kryhet vepra penale, duke u vënë në dispozicion të kryesit mjetet për të kryer një vepër penale, largimin e pengesave për të kryer një vepër penale, ose duke premtuar paraprakisht për të fshetur provat e kryerjes së veprës penale, ose fitimin që është rezultat i kryerjes së një vepre penale”.

Neni 341 që definon veprën penale të Mashtrimit në Detyrë, në pjesët përkatëse thotë si në vijim:

“(1) Një person zyrtar i cili me qëllim për të përfutuar të mira materiale të paligjshme për vete ose një person tjetër duke prezantuar një deklaratë të rrejshme të një llogarie ose në ndonjë mënyrë tjetër mashtron një person të autorizuar për të nxjerrë një pagese të paligjshme, do të dënohet...”

Në vendimin e vet trupi gjykues konstatoi se secili operator ekonomik ka marr pjesë në skemën në të cilën kanë nënshkruar dokumente për punë të pa kontraktuar dhe punët që nuk i kanë kryer në vende të parapara. Përveç kësaj, trupi gjykues konstatoi se pagesat që janë kërkuar për këto punë janë deklaruar rrejshëm në shuma progresive të dizajnuar që t'i shmangen procesit të shqyrtimit që kishin gjasa të zbulojnë natyrën e rrejshme të kontratave. Trupi gjykues më tej konstatoi se këto dokumente false kanë formuar bazën për të pandehurit **G.** dhe **V.**, “personat zyrtar” për të kërkuar fonde buxhetore për të paguar shumat e paraqitura nga operatorët ekonomik.

Duke marr parasysh konstatimet e trupit gjykues, është e qartë se faktet që u dëshmuan tregojnë se operatorët ekonomik qëllimisht “vunë në dispozicion të kryesve (**G.** dhe **V.**) mjetet për të kryer një vepër penale duke nënshkruar deklaratë të rrejshme të llogarive që u shfrytëzuan të mashtronjë një person të autorizuar në qeveri për të bërë pagesa të paligjshme. Kështu, nën kodin e vjetër, operatorët ekonomik do të shpallehin fajtorë për dhënien e ndihmës në Mashtrim në Detyrë.

Mashtrimi në Detyrë, “bashkë kryerje” and “Ndihmë” sipas kodit aktual

Mashtrimi në Detyrë

Përveç ndryshimeve lidhur shumëve që definojnë nivelin e seriozitetit të veprës penale, definimin e krimit Mashtrimi në Detyrë në Nenin 426 të kodit aktual penal është identik me atë të kaluarën.

Një ndryshim në mes të kodit të vjetër dhe kodit aktual sidoqoftë ekziston në Nenin 120 të Kodit aktual që ka të bëjë me “Personin Zyrtar” e që nuk përmban analogji me Nenin 107 (3) të kodit të mëparshëm, i cili është si në vijim:

“Kur një person zyrtar ... përshkruhet si kryes i një vepre penale, të gjithë personat e referuar në paragrafin 1 ose 2 të Nenit aktual mund të jenë kryes të një vepre të tillë penale, me kusht që

mos të del nga elementet e veprës penale që kryesi mund të jetë vetëm njëri nga ata personat.”
(Theksi është shtuar)

Kështu që duket se sipas kodit aktual nuk kam kërkesa që sa i përket Mashtrimit në Detyrë vetëm një “person zyrtar” mund të veprojë në bashkë kryerje me një “person tjetër zyrtar”. Duke e marr parasysh eliminimin e këtij restriksioni, dispozita e kodit të ri paraqet një pyetje interesante. Pyetja lind kur një përpjekje për të vendosur në mes të zbatimit të Nenit 31 lidhur me “bashkë kryerjen: dhe zbatimin e Nenit 31 lidhur me “asistencën”.

Neni 31 Bashkëkryerja

“Kur dy ose më tepër persona së bashku kryejnë një veprë penale duke marr pjesë në kryerjen e një veprë penale ose duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në ndonjë mënyrë, secili prej tyre do të jetë përgjegjës dhe do të dënohet siç përshkruhet për veprën penale.”

Neni 33 Ndhma

“1. Kushdo që qëllimisht ndihmon një tjetër në kryerjen e veprës penale do të dënohet më butë.

2. Ndhma në kryerjen e veprës penale përfshinë, por nuk kufizohet vetëm në: dhënien e këshillës ose udhëzimeve se si të kryhet një veprë penale; dukë vënë në dispozicion mjetet për të kryer një veprë penale; krijimin e kushteve ose largimin e pengesave për të kryer veprën penale; ose duke premtuar paraprakisht për të fshehur provat e kryerjes së veprës penale, kryesin ose identitetin e kryesit, mjetet e shfrytëzuara për të kryer veprën penale ose fitimin e siguruar si rezultat i kryerjes së veprës penale”

Siç mund të shihet, në Nenin 31 ekzistojnë dy mënyra të definuara për të kryer veprën penale së bashku: 1) “duke marr pjesë në kryerjen e veprës penale” ose 2) “duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në ndonjë mënyrë tjetër”. Kjo do të thotë se duhet shikuar së pari në definimin e qartë të kryerjes së veprës penale. Këtu, vepra penale e fundit ishte kanalizimi i fondeve të agjencisë për të ndërtuar projekte të pa autorizuara. Nga faktet e dëshmuara është e qartë se kanalizimi i gabuar i fondeve ishte rezultat i drejtë për drejtë i veprimeve të dy “personave zyrtar”, **G.** dhe **V.**, që punonin në marrëveshje. Kështu, sipas kodit aktual, sikurse edhe me kodin e vjetër, të pandehurit **G.** dhe **V.**, mund të dënohen për Mashtrim në detyrë në bashkë kryerje. Një pyetje më interesante lind sa i përket operatorëve ekonomik.

Gjersa mund të kontestohet se veprimet e operatorëve ekonomik mund të bien brenda definicionit të bashkë kryerjes sipas gjuhës së “kontribuimit të konsiderueshëm në kryerjen e saj në ndonjë mënyrë tjetër” të nenit 31, ky Kolegj konstaton ndryshe. Veprimet e operatorëve ekonomik duket se kanë rra në mënyrë më të qartë në kuadër të dispozitave të Nenit 33, paragrafit 2 që definon “ndihmën” në atë se nëpërmjet veprimeve të tyre të bërjes së dokumenteve të rrejshme ata kanë vënë në “dispozicion mjete për kryerje të veprave penale” shumë se sa që kanë ndihmuar në kryerjen e veprave aktuale penale. Kështu, ky kolegj konstaton se, mu sikurse sipas kodit të vjetër, dënimi i drejtë për operatorët ekonomik do të duhej të ishte për Ndhmë në Mashtrim në detyrë

Dënim i dyfishtë për Shpërdorim të Pozitës zyrtare dhe të autorizimit dhe Mashtrimin në detyrë

Te pandehurit **G.** dhe **V.**, secili janë dënuar për të dy veprat, të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare dhe të Autorizimit dhe për Mashtrim në Detyrë. Vepra penale e shpërdorimit të Pozitës zyrtare dhe të autorizimit është definuar në Nenin 339. Në pjesët përkatëse thuhet:

“(1) Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin ose për organizatën e biznesit ... shpërdoron pozitën e tij zyrtare, tejkalon kompetencat ose nuk i përmbush detyrat zyrtare dënohet...”

Mashtrimi në Detyrë definohet në pjesën përkatëse në Nenin 341 si në vijim:

“(1) Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër bënë prezantimin e rremë të raportit të llogarive apo i cili në mënyrë tjetër e vë në lajthim personin e autorizuar në kryerjen e pagesës së kundërligjshme dënohet...”

Prokurorja shtetërore ve Apelit në mendimin e saj pohon se edhe pse këto dy vepra penale mbrojnë vlerë të njëjtë shoqërore, bashkëveprimi i tyre në rastin aktual është real meqë ata pjesërisht ndajnë elemente identike dhe sjellja e veprave penale ndryshon. Kështu, ajo propozon se të pandehurit mund të dënohen për të dy vepra penale dhe mund të dënohen me dënim unik. Të pandehurit në parashtrësat e tyre kontestojnë se të pandehurit mund të dënohen vetëm, nëse fare munden, për veprën e vetme penale të Mashtrimit në detyrë, Gjykata e shkallës së parë nuk e ka diskutuar çështjen e bashkëveprimit në aktgjykimin e saj në mënyrë të qartë, por thjeshtë cakton një dënim unik, p.sh duke supozuar bashkë veprim në rastin aktual. Në përgjithësi, koncepti i bashkë veprimit të veprave penale dallon në mes të ashtu quajturës bjeshke veprim real dhe bashkë verim ideal.

Bashkëveprim real përfaqëson rastet ku një person me një sërë të veprimeve të ndara kryen disa vepra penale kundër një ose më shumë viktimave, në rastin aktual kryesi është përgjegjës për shkelje të rregullave të ndryshme të ligjit penal. Asnjë problem i veçantë nuk lind lidhur me akuzimin e kryesit dhe dënimit nga ana e gjykatës; ai do të akuzohet për vepra të ndryshme penale; nëse shpallet fajtor, do të dënohet për secilën vepër penale, me shqiptimin e dënimit më të lartë. Një person mund të shkelë rregullin e njëjtë kundër personave të ndryshëm: për shembull, vret anëtarët e një familjeje të tërë. Në këtë rast vetëm një rregull është shkelur, që ndalon vrasjen, por vepra penale është kryer kundër disa viktimave.

Bashkë kryerje ideale, në anën tjetër, mbulon rastet ku një person, me një veprim të vetëm ose një transaksion në mënyrë simultane shkel më shumë se një rregull. Këtu, përsëri, njëri dhe të bëjë dallim në mesin e kategorive të ndryshme të shkeljeve. Së pari, mund të ndodhë se veprimi i njëjtë deri diku shkelë një rregull, kurse në kuptimin tjetër shkelë një rregull tjetër, dy rregulla që mbulojnë çështje të ndryshme. Në rastet e tilla, sjellja e njëjtë penale në mënyrë simultane shkelë dy rregulla të ndryshme dhe përbënë dy vepra të ndryshme penale. Sidoqoftë, kjo varret nga rregulla e veçantë (*lex specialis derogat lex generalis*).

Nëse të dy rregullat janë dispozita ligjore, shumica e sistemeve të ligjeve civile konsiderojnë se kryesi duhet të dënohet për të dy veprat penale, me dënim më të ashpër të mundshëm. Nëse njëra nga rregullat është dispozitë e veçantë, kjo dispozitë duhet të aplikohet dhe Gjyqtari të caktojë dënimin e përmendur në dispozitën e veçantë me tepër se sa në dispozitën e përgjithshme.

Arsyetimi pranë parimit të veçantë është se nëse një veprim është rregulluar ligjërisht me dispozita të përgjithshme dhe me atë të veçantë, ajo e dyta dominon si më e duhur, duke qenë në mënyrë specifike e drejtuar ndaj atij veprimi. Në veçanti në rastin e diskrepancës në mes të dy dispozitave, do të ishte e logjikshme të supozohet se organi ligj vënës e ka pasur për qellim për t'i dhënë përparësi dispozitës që qeveris veprimin në mënyrë më të drejtë për drejtë në me shumë detaje. Kur njëri ballafaqohet me një sjellje të vetme ose transaksion që në mënyrë të një pas njëshme shkelë dy rregulla të ndryshme *vis-a-vis*, viktimja e njëjtë mundet në teori të përbëjë dy vepra penale, por njëra është me e vogël se sa tjetra, parimi i konsumimit vjen në shprehje: vepra penale më serioze dominon dhe përfshin, si të thuash, tjetrën.

Çështja ligjore e bashkë veprimit të veprës penale tanimë është trajtuar nga ana e Gjykatës së Apelit, ndër të tjera në rastin *Puka dhe të tjerët* ku Gjykata konstaton se vepra penale Nxjerrjes së Kundërligjshme të Vendimit Gjyqësor është *lex specialis* në lidhje me veprën penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare dhe të Autorizimit. E njëjta sipas mendimit të kolegjit vlen për veprën penale të Mashtrimit në Detyrë⁴. Kështu, Gjykata e Shkallës së Parë ka shkelur ligjin penal kur ka dënuar të pandehurit **G.** dhe **V.**, për dy veprat penale. Aktgjykimi do të duhej ndryshuar në lidhje me këtë për të reflektuar vetëm dënimin për Mashtrim në detyrë.

Dënimi për Mashtrimin në Detyrë për G.-in dhe V.,-in

Trupi gjykues i shpalli këta të pandehur fajtor sipas kodit të vjetër. Në lidhje me këtë dënim, trupi gjykues konstatoi se për secilin të pandehur dënimi i duhur për krimin e Mashtrimit në Detyrë ishte 3 vjet burgim dhe si dënim plotësues sipas Nenit 54 dhe 56 të ish kodit penal caktoi masën e ndalesës kundër ushtrimit të funksioneve në shërbimet publike dhe në administratën publike për një periudhë dy vjeçare.

Për të përcaktuar nëse gjykata kishte të drejtë të procedojë sipas kodit të vjetër si më e favorshme për të pandehurit, neve duhet ekzaminuar dispozitat e kodit aktual penale po ashtu. Siç u cekë më herët neve gjejmë se elementet e krimit janë të njëjta. Duke marr parasysh se elementet bazë të krimit janë të njëjtë sipas kodit të ri dhe të vjetër, faktori i vetëm ndryshues gjendet në aspektin e dënimin]t të secilit ligj.

⁴ Shih gjithashtu S. Nikola, *Komentari i Kodit Penal të Serbisë, edicionin i 5-të 1995, neni 242, par. 8: "Në lidhje me këto vepra penale [shkeljes së ligjit nga ana e gjyqtarit; Mashtrimi në Detyrë; ndërmjetësimi të paligjshme; marrja e ryshfetit] shpërdorim i detyrës është një akt i përgjithshëm penale dhe nuk mund të jetë në bashkëveprim ideale me ato meqë janë forma të veçanta të abuzimit. Nëse nga ndonjë shpërdorim të detyrës një kryes e kupton thelbin e akteve të lartpërmendura, do të mbahet përgjegjës vetëm për vepër të veçantë penal sipas parimit të veçantë "; shih më tej L. Lazareviç, Komenti mbi Kodin Penal të RFJ-së, 1999, Neni 174: "Shpërdorimi i detyrës është akt themelor penale kundër detyrës zyrtare. Megjithatë, disa vepra të tjera penale nga ky grup gjithashtu përfshijnë veprimin e paligjshëm të zyrtarëve nga shpërdorimi i pozitës ose të autorizimit të tyre, dhe në këtë kuptim ata përfaqësojnë forma të veçanta të kësaj vepre penale. Prandaj bashkëveprimi ideale në mes tyre nuk është i mundur*

Meqë të pandehurit kryen veprat e tyre penale nën kodin e vjetër penal ku dënimi maksimal për përfitimi pasuror që tejkalon shumën 5000 €, atëherë duhet të shikojmë dënimin për nivelin e fajësimit në secilin kod për të përcaktuar se cili duhet zbatuar. Nëse bëjmë këtë, gjejmë se sipas kodit të vjetër dënimi shtrihet nga 1 deri në 10 vjet. Sipas Kodit të ri dënimi shtrihet nga 1 deri në 8 vjet. Kështu, kodi i ri është më i favorshëm për të pandehurit dhe do të duhej të zbatohet. Natyrisht, ky konkludim nuk ka kuptim praktik meqë dënimet që janë shqiptuar këtyre dy të pandehurve bien në kuadër të shtrirjes së lejuar pavarësisht se cili kod zbatohet, i vjetri apo i ri.

Ekziston një çështje lidhur me dënimin që bënë ndryshimin dhe i cili ka nevojë të trajtohet. Të dy të pandehurit kanë marr dënim unik meqë ishin dënuar për dy vepra penale, Mashtrim në Detyrë dhe Shpërdorim të Pozitës Zyrtare. Trupi gjykues gjenë se **G.** do të duhej të merr dy vjet burgim për Shpërdorim të Detyrës Zyrtare dhe 3 vjet për Mashtrim në Detyrë. Si dënim unik gjykata konstaton se dënimi i duhur do të duhej të ishte 4 vjet. Kurse sa i përket **V.-it**, trupi gjykues konstaton se për Mashtrim në Detyrë dënimi i duhur ishte 3 vjet, kurse për Shpërdorim të detyrës Zyrtare dhe të Autorizimit ishte 2 vjet, me një dënim unik 3 vjet e 6 muaj burgim.

Duke marr parasysh faktin se kemi përcaktuar se këta dy të pandehur do të duhej të dënohen vetëm për Mashtrim në Detyrë, shtrohet çështja se çfarë dënimi duhet shqiptuar për secilin prej tyre, Sa për fillim, trupi gjykues vlerësoi secilën akuzë veç e veç në lidhje me shqiptimin e dënitimit dhe përcaktoi se për Mashtrimin në detyrë dënimi për secilin të pandehur do të duhej 3 vjet..

Neni 417 o Kodit të Procedurës Penale thotë:

“Aty ku vetëm një ankesë në favor të të akuzuarit mund të parashtrohet, aktgjykimi nuk mund të ndryshohet në dëm të të akuzuarit lidhur me klasifikimin e veprës dhe dënitimit të shqiptuar”.

Në këtë rast prokuroria nuk ka parashtruar një ankesë lidhur me këta dy të pandehur.

Duke marr parasysh dispozitat e Nenit 417, dënimi më i gabuar që mund të caktohet kundër këtyre të pandehurve është ai që ishte shqiptuar nga trupi gjykues siç është përcaktuar sipër. Pastaj lind pyetja nëse një dënim më i ultë do të duhej të shqiptohet duke marr parasysh se këta të pandehur do të dënohen vetëm për një e jo vepër penale?

Kjo gjykatë konstaton se kufizimi i të pandehurve në vetëm një dënim e jo dy lind nga zbatimi i duhur i ligjit dhe jo nga ndonjë ndryshim në rrethana faktike. Dënimet e shqiptuara nga ana e trupit gjykues ishin të arsyeshme dhe pranohen nga kjo gjykatë si dënim i duhur për këta të pandehur për Mashtrim në Detyrë.

Dënimi për Ndhimë në Mashtrim në detyrë për Operatorët Ekonomik

Duhet të fillojmë duke zbatuar disa analiza siç jemi shërbyer më artë lidhur me **G.** dhe **V.**,. Së pari duhet vënë në dukje se sikurse me **G.** dhe **V.**,, krimi për të cilin operatorët ekonomik akuzoheshin dhe u dënuan në bashkëveprim ishte Mashtrim në Detyrë për përfitimet që tejkalonin 5000 €. Kështu, po ashtu sipas analizave të më sipërme, bazë për dënimin sipas kodit të vjetër ishte shtrirja nga 1 deri në 10 vjet, kurse 1 deri në 8 vjet sipas kodit të ri.

Hapi i radhës në analizat që duhesh zbatuar për operatorët ekonomik është që të shihet se çfarë parasheh secili kod për dënimin për “ndihmë” në Mashtrim në Detyrë. Sipas Nenit 25 të kodit të vjetër jemi të udhëzuar të zbatojmë dispozitat e Nenit 65 (2). Ky paragrafi kodit parasheh se dënimi për “ndihmë”, “...nuk do të jetë më shumë se tri të katërtat e dënimit maksimal të përshkruar për veprën penale”. Kështu, sipas kodit të vjetër dënimi maksimal ishte 10 vjet kështu që dënimi maksimal për “ndihmë” do të ishte 7 vjet e gjashtë muaj.

Po qe se i qasemi kodit të ri, neni 33 (1) thjesht parasheh se, “Kushdo që me qëllim ndihmon një person tjetër për të kryer veprën penale, do të dënohet më butë”. Për të zbatuar këtë dispozitë në rastin tonë kërkohet një analizë dy hapash.

Pjesa e parë e analizës kërkon një përcaktim të kuptimit gjuhësor, “...më të butë”. Në rastin tonë ku kryesit kryesor ishin dënuar në të njëjtën kohë operatorët ekonomik të cilët i “ndihmonin: ata, analiza është shumë e drejtë për drejtë. Nëse ndjekim analizën e sipërme, **G.** dhe **V.**, si kryes kryesor do të duhej të dënoheshin në mënyrë të duhur Deklarata e të dënohen sipas kodit të ri dhe dënimi i tyre është 3 vjet për secilin. Është e logjikshme të zbatohet kodi i ri po ashtu edhe për operatorët ekonomik të cilët janë dënuar për atë që kanë ndihmuar ata. Nëse veprojmë kështu, atëherë dënimi për operatorët ekonomik do të duhej të ishte më i butë se ai që i ishte shqiptuar **G.** dhe **V.**. Meqë operatorët ekonomik në fakt morën dënimet nga gjykata, të cilat ishin më të buta se dënimet e shqiptuara kundër **G.** dhe **V.**, kodi i ri është përputhje me të gjithë pjesëmarrësit që janë dënuar sipas kodit të njëjtë.

Pasi që u përcaktua se dënimet e dhëna operatorëve ekonomik janë në përputhje me kërkesat statutores të nenit 33 (1) të kodit të ri, mbetet pyetja nëse këto dënime janë të duhura megjithatë duke marr parasysh ndryshimin e krimit dhe dënimin për Mashtrim në Detyrë në bashkë kryerje për të Ndihmuar në Mashtrim në Detyrë.

Dispozita e Nenit 417 thotë:

“Aty ku vetëm një ankesë në favor të të akuzuarit është parashtruar, aktgjykimi nuk mund të ndryshojë në dëm të të akuzuarit sa i përket klasifikimit të veprës dhe dënimin penal të shqiptuar”.

Meqë ankesa e prokurorisë kishte të bëjë vetëm me lirimimin e të pandehurit Petkoviç dhe ankesa u konstatua se ishte e pa pranueshme, dënimet e shqiptuara nga trupi gjykues janë mbi limitin për dënimin që mund t’i shqiptohet këtyre të pandehurve.

Trupi gjykues dënoi të pandehurit **M.S., R.P., I.H.** dhe **F.S.** me 1 vit e 6 muaj burgim, por me kusht për 3 vjet. Në lidhje me të pandehurit **R.S., Sh.H., G.Z.** dhe **D.H.**, trupi gjykues dënoi secilin me 1 vit burgim por pastaj pezulloi këto dënime me kusht për 3 vjet. Ndryshimi në dënimet në mes të dy grupeve është bazuar mbi gjetjet e trupit gjykues se grupi i parë ka përfituar të mira pasurore më shumë se sa grupi i dytë nëpërmjet aktivitetit kriminal.

Pas shqyrtimit të fakteve dhe arsyesimit të trupit gjykues në lidhje me dënimet e shqiptuara, kjo gjykatë nuk gjenë arsye që të reduktojë në masë të konsiderueshme dënimet në veçanti meqë trupi gjykues i sheh dënimet aktuale si minimale. Megjithatë, për t’i dhënë të paktën pakës njohje

faktit se këta të pandehur tani po shpallen fajtor për një vepër më të vogël penale, dënimet për të pandehurit **M.S., R.P., I.H.** dhe **F.S.** janë reduktuar në 1 vit dhe 4 muaj burg, me kusht për 3 vjet. Dënimet për të pandehurit **R.S. Sh.H., G.Z. dhe D.H.** zvogëlohen në 10 muaj burgim, më kusht që vepra të mos përsëritet brenda 3 viteve.

Në kohën e argumentimit të këtij rasti në seancat publike, avokati i të pandehurit **R.P.** ngriti çështjen e llogaritjes së kohës që ka kaluar në paraburgim. Si duket i pandehuri ka qëndruar 10 ditë në paraburgim dhe, në pajtim me dispozitat e Nenit 73 kjo periudhë kohore i është llogaritur në dënimin me burg që i është shqiptuar të pandehurit.

Vlerësimi i shpenzimeve

Trupi gjykues “përcaktoi” shumën e shpenzimeve të procedurës penale duke u bazuar në deklaratat si në vijim: *“duke marr parasysh numrin ë përgjithshëm të dëshmitarëve, seancat e mbajtura dhe ndihmën ligjore ndërkombëtare që është kërkuar, shpenzimet e procedurës penale CAKTOHEN ne shumë prej 3000 € (tre mijë euro) në pajtim me Nenin 100, paragrafin 2 të KPPK-së”*. Një shqyrtim i dispozitave të kodit aktual të procedurës penale zbulon se gjuha e Nenit 450 dhe 451 janë gati identike dhe nuk ndryshojnë në asnjë mënyrë në kuptimin substancial që është relevante për këtë procedurë.

Është e qartë se trupi gjykues nuk arriti të përcaktojë shpenzimet në pajtim me dispozitat e Nenit 99 dhe Nenit 100 (2) të kodit të më parëm ose Nenit 450 dhe 451 të Kodit aktual, por thjeshtë zbuloi një shumë pa asnjë bazë faktike. Meqë nuk ekziston asgjë e konstatuar mbi të cilën të bazohet një përcaktim i vërtetë i shpenzimeve, obligimi i caktuar mbi të pandehurit për të paguar shpenzimet anulohet dhe janë të liruar nga ndonjë obligim për të paguar shpenzimet

E shkruar në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar. Aktgjykimi i Arsytuar u kompletua më datë 25 Gusht 2014.

Gjyqtar Kryesues

James Hargreaves
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtar i Kolegjit

Anëtar i Kolegjit

Manuel Soares
Gjyqtar i EULEX-it

Driton Muharemi
Gjyqtar

Zyrtar Ligjor

Clemens Mueller
Zyrtar Ligjor i EULEX-it

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS
PAKR 943/13
25.08.2014